

150



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
TIRANË  
DHOMA CIVILE

11.09.12.2024.  
VERTETOHET NJESIA ME  
ORIGINALIN FQ (3.)  
SEKRETAR I REGJISTRIT  
*[Signature]*

Nr.Regj.Them. 686  
Data e Regjistrimit 13.04.2022

Nr. Vendimit 5934/1  
Data 23.09.2022



**VENDIM**  
Në emër të Republikës

(PËR DEPOZITIM VENDIMI NË REGJISTRIN E OJF-ve)

GJYQTARE: Enkela Bajo Vlora

sot më datë 23.09.2022, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, kërkesën që i përket:

**KËRKUES:** Shoqata Komiteti Olimpik Kombetar Shqiptar (KOKSH), me adrese rruga Muhamet Gjollësja, sheshi Mustafa Atatürk, Tirane

**OBJEKTI:** Depozitimin dhe rregjistrimin e vendimit date 02.04.2022 te Asamblese se Pergjithshme te Jashtezakonshme (APJ) te Komiteti Olimpik Kombetar Shqiptar (KOKSH)

**BAZA LIGJORE:** Kushtetuta e RSh; ligji 8788/date 07.05.2001 dhe ligji 8789/date 07.05.2001; ligji 79/2017, i ndryshuar .

Gjykata, pasi shqyrtoi në dhomë këshillimi kërkesën dhe aktet bashkëlidhur saj,

**VËREN**

Komiteti Olimpik Kombetar Shqiptar (KOKSH) eshte organizate shoqerore joqeveritare, jo fitimprurese, e rregjistruar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane me vendim Nr. 5934 , Dt. 22/ 06 /2018 dhe qe rregullohet sipas akteve te saj themeluese-akt themelimi dhe statut;ne keto gjejme te parashikuara emertimin,organizimin e saj,etj.

Nga ana e ketij subjekti jane depozituar ne vijim ne gjykate akte mbi ndryshimet e bera (perkatesisht me vendimet gjyqesore nr.5934/1,5934/2 dhe 5934/3).

Ne daten 12 Prill 2022, Komiteti Olimpik Kombetar Shqiptar, i eshte drejtuar me kerkese Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tirane, per rregjistrimin e vendimeve te marra nga Asambleja e Pergjithshme e Jashtezakonshme e Dates 02.04.2022, Asamble kjo e kerkuar nga 1/3 e anetareve te saj, bazuar ne nenin 18 te Statutit te KOKSH, me Rend te Dites si me poshte;

1-Mocion mosbesimi pe mbajtesin e thesarit te Komitetit Egzekutiv te KOKSH,z.Genc Boga(dhe aresyet)

2-Mocion mosbesimi per anetaren e Komitetit Egzekutiv te KOKSH , zj.Tatjana Marash(dhe aresyet).

Sipas Proces-verbalit te mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme te Jashtezakonshme te dates 02/Prill/2022, si edhe Memorandumit te Dates 05/Prill/2022 te mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme te Jashtezakonshme te KOKSH,ne teresine e tyre anetaret e KOKSH me te drejte vote perfaqesohen nga 63 individe dhe ne APJ ishin present 58 individe ,fakt mbi te cilin KEV vleresoi se kuorumi prej 2/3 te 63 individeve eshte arritur.

Ne mbledhjen e asamblese te mbajtur me kuorumin e nevojshem prej 2/3,eshte vendosur:

1-Aprovimi i mocionit te mosbesimi nga Asambleja e Pergjithshme e Jashtezakonshme dhe shkarkimin e menjehershem te Z. Genc Boga nga detyra si anetar I KE si edhe nga Mbajtes i Thesarit te KOKSH.

2-Aprovimi i mocionit te mosbesimi nga Asambleja e Pergjithshme e Jashtezakonshme dhe shkarkimin e menjehershem te Znj. Tatiana Marash nga detyra si anetare e KE te KOKSH.

Nga pala kerkuese se bashku me kerkesen jane paraqitur dhe teresia e akteve shoqeruese (plotesuar ne vijim nga pala kerkuese mbi bazen e detyrave te lena nga gjykata),si:kerkesa per thirrje te asamblese se jashtezakonshme,procesverbali I mbledhjes, memorandumit,aktet e mbajtura nga KVE,procesverbale mes Sekretariatit te KOKSH dhe KVE,listat e pjesemarrjesve me te drejte dhe pa te drejte vote,email per njoftim zyrtar te mbledhjes se asamblese,etj.

Nisur nga teresia e dokumentacionit te paraqitur ne gjykate dhe bazuar ne rregullimet e statutit te shoqates mbi asamblene, kompetencat e saj,menyren e thirrjes se asamblese,kuorumet perkatese, vlefshmerine e vendimmarrjes,etj( me konkretisht nenet 16,18 e vijues),mbi komitetin egzekutiv,etj gjykata cmon qe kerkesa dhe aktet jane te bazuara ne prova ,ne statut dhe ne ligj dhe duhet te pranohen.

### PER KETO ARSYE

Ne mbeshtetje te ligjit 7850 date 29.07.1994 nenet 39-53 te ligjit 87814 date 03.05.2001, ligjit 8788 dt 07.05.2001 dhe Ligji NR.8789 DT.07/05/2001.


### VENDOSI



151

1- Pranimin e kerkeses.

Depozitimim e Proces-verbalit dhe Memorandumit te dates 05/04/2022 te mbledhjes se Asambles se Pergjitheshme te Jashtezakonshme te Komitetit Olimpik Kombetar (KOKSH), ne te cilin eshte vendosur:



-Aprovimi i mocionit te mosbesimi nga Asambleja e Pergjithshme e Jashtezakonshme dhe shkarkimin e menjehershem te Z. Genc Boga nga detyra si anetar I KE si edhe nga Mbajtes i Thesarit te KOKSH.

2-Aprovimi i mocionit te mosbesimi nga Asambleja e Pergjithshme e Jashtezakonshme dhe shkarkimin e menjehershem te Znj. Tatiana Marash nga detyra si anetare e KE te KOKSH.

2-Depozitimim e ketij dokumentacioni dhe akteve shoqeruese prane Zyres se Rregjistrimit te Organizatave Jofitimpruese te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

3-Urdhërohet Zyra e Regjistrimit të OJF-ve të pasqyrojë në regjistër ndryshimet përkatëse.

-Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim.

-U shpall sot më datë 23.09.2022 në Tiranë.

**GJYQTARE**

**Enkela Bajo Vlora**

